

FJALA E DEPUTETIT TOMOR ALIZOTI

E ENJTE 28 PRILL 2022

Zonjë e nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

Të flasësh 6 minuta për një sistem, që ndenji gjysmë shekulli dhe prodhoi një shoqëri të nënshtruar; prodhoi një Kuvend që reciton dhe prodhoi deputetë që qeshin kur qesh kryetari, duartrokasin kur flet kryetari dhe nuk prodhoi parti bashkëpunuese, por parti nënshtruese; të flasësh 6 minuta për komunizmin, i cili filloi me terrorin e kuq të Stalinit, që vrau mbi 20 milionë veta dhe e çoi terrorin dhe spastrimin e kuq në vrasjen e mbi 1000 vetave në ditë; të flasësh për maoizmin, i cili vetëm në 5 vjetët e parë vrau 45 milionë veta; të flasësh për partinë e Stalinit, i cili në Holodomor, në luftën që sot bëhet në Ukrainë, vrau 6 milionë veta dhe përsëri sot Ukraina përballet me një ish-anëtar të KGB-së për të mbijetuar; të flasësh për Gjermaninë Lindore, e cila për herë të parë në historinë e njerëzimit, në vendin e Gëtes, u rrethua me një mur dhe të thuash që kjo ideologji vrastare erdhi në një popull të vogël me zemër të madhe, i cili jetonte me traditat e tij, të cilat pasqyrohen në të gjitha literaturat e mendimtarëve europianë, të sjellin një ideologji të kombinimit maoist dhe stalinist, në të cilin u izolua për gjysmë shekulli dhe parlamenti, Kuvendi i Shqipërisë, flet vetëm një herë në vit 20 minuta për të vlarët në kufi, për njerëzit që sot hanë dhe, për trupat e pagjetur, për të rinjtë e ambasadave, për një shoqëri, e cila sot nuk është e aftë të ketë demokraci pikërisht nga stalinizmi, maoizmi dhe enverizmi, për një shoqëri banale.

Kam lexuar një histori shumë të dhimbshme për vajzën e Emine Canes, e shoqja e një të arratisuri, e cila ishte e internuar në Lushnjë. Të internuarit në atë kohë, për bijtë e Bllokut, që nuk e dinë, duhet të merrnin leje për çdo lëvizje që bënin nga fshati. Vajza, Afërdita, ishte 4 vjeç dhe u sëmur. Leja nga operativi erdhi shumë vonë dhe ajo nënë u nis në këmbë dhe bëri 14 kilometra për në Lushnjë. Askush nuk e mori me makinë, sepse ky sistem prodhoi frikë. E çoi vajzën e saj dhe u kthye me vajzën e vdekur duke bërë 14 kilometra në këmbë, gjë që s'ka ndodhur ndonjëherë në historinë e këtij kombi qëkur është krijuar. Pra, komunizmi prodhoi një shoqëri pa empati. Emine Cane e ktheu vajzën në krah, duke bërë 14 kilometra në këmbë, në vendin ku deputeti i PS-së as nuk denjon ta dëgjojë. Ajo u kthye në këmbë me vajzën e vdekur në dorë, shkoi në shtëpi dhe askush nuk e mori me makinë, askush nuk e

ndihmoi. Ky komunizëm prodhoi një shoqëri pa empati, prodhoi banalitet në këtë sistem, ku shqiptarët vranë shqiptarët.

Ky nuk është një sistem as i të persekutuarve, as i ballistëve, as i partizanëve, ky është një sistem që dhunoi kombin shqiptar, ky është një sistem ku shqiptarët ende sot nuk prodhojnë dot demokraci, ende sot në Shqipëri partia është shtet, ende sot në Shqipëri diskursi politik është kinostudio, ende Kuvendi i Shqipërisë nuk ka tagrin, nuk ka logjikën, nuk ka mendimin të bëjë një fjalim politik. Kryeministri i Shqipërisë nuk mban dot një fjalim politik, e ka të pamundur dhe rreshton të gjithë stafin politik të votojë. Është fatkeqësi e madhe që një vend, që iu bashkëngjiti Maos dhe Stalinit dhe sot do t'i bashkohet Europës flet një herë në vit për historinë e vet të trishtë, për fatkeqësinë e vet. Kjo është fatkeqësi e kombit shqiptar, kjo nuk është fatkeqësi e të persekutuarve dhe as e grupimeve të tjera. Kjo është fatkeqësi e një kombi të vogël, i cili mori një doktrinë, që shkatërroi botën.

Në Shqipëri sot diskutohet dhe zgërdhohet për jetët e humbura, për njerëzit pa varre, për fatkeqësinë që kanë kaluar njerëzit. Unë pata fatin e keq të shikoja kampet e përqendrimit, që ndërtoi partia juaj nënë, Spaçin, Qafë-Barin, pata kurajën për të parë Auschwitz-Birkenau-n, shfarosjen e nazistëve nëpërmjet gazit, ndërsa në kampet e përqendrimit të Shqipërisë ishte shfarosja nëpërmjet punës. Jua them me bindje se Spaçi nuk kishte ndonjë dallim të madh nga Aushvici. Është fatkeqësi e madhe, është turp kombëtar për ju, si të majtë, dhe për të gjithë si shoqëri që duhet të distancohemi. Ka ende njerëz në grupin tuaj parlamentar që dalin më fotografitë e Maos, Stalinit dhe Enverit. Kjo është një fatkeqësi për kombin shqiptar, jo për të persekutuarit. Për të folur për komunizmin nuk duhen 6 minuta, por duhen 60 ose 600 vjet. Unë ju falënderoj të gjithëve!